



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË KULTURËS DHE INOVACIONIT

AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

SHKOLLA E MESME TEKNOLOGJIKE "HYSEN ÇELA" DURRËS

Nr. 46 Prot.

Durrës, më 19.9 2025

Lënda: Njoftim për vënd të lirë.

DREJTORISË JURIDIKE DHE BURIMEVE NJERËZORE

AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Rruga "Bulevardi Bajram Curri", Tiranë

Në zbatim të ligjit nr.15/2019, "Për nxitjen e punësimit", të ligjit nr.15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.554, datë 31.7.2019, "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive", të Udhëzimit nr. 759, datë 30.09.2024, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimit e burimeve njerëzore, përbërjes së njësisë së zhvillimit të institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit" i ndryshuar.

Shkolla e Mesme Teknologjike "Hysen Çela" ju njofton krijimin e vendit të lire për pozicionin/pozicionet:

- Pozicioni: - 1 (Një) Instruktor i praktikës profesionale, drejtimi Hoteleri-Turizëm (Bar-Restorant)

1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme si vijon:

Kritere të përgjithshme: a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar; b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën; c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale; d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë

shuar; e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit; f) të demonstrojë aftësi drejtuese, të punës në grup dhe motivimit.

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

Kritere të posaçme për instruktor të praktikës profesionale:

a) Të ketë të paktën një shkollë e mesme profesionale , pas të mesme ose parauniversitare në të njëjtën fushë me kualifikimin/kualifikimet profesionale për të cilin/cilat po aplikon; b) të ketë të paktën 3(tre) vjet përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit; d) aftësi të tjera nëse kërkohen.

2. Dokumentet e aplikimit

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë: a) letërmotivimin për pozicionin; b) jetëshkrimin (CV-në); c) kartën e identitetit; d) diplomën; e) librezën e punës; f) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV ; g) certifikatë ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit; h) vërtetimi të gjendjes shëndetësore; i) vërtetim të gjendjes gjyqësore; j) vërtetimin nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi; k) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara .

Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në zyrën e protokollit në Shkollën e Mesme Teknologjike “Hysen Çela”, brenda afatit 28.05.2025

3.Vlerësimi i kandidatëve do bëhet referuar përcaktimeve të udhëzimit nr.759, datë 27.5.2024, “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimit e burimeve njerëzore, përbërjen e njësisë së zhvillimit të institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit”, i ndryshuar.

DREJTORE

Dr. Blerina DERVISHI

Adresa: Lagja Nr.16 Rruga "Mbreti Gent" Durrës

e-mail: hcelamp@yahoo.com

